# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-449135**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Dënimi i ish krerëve të UÇK - Kreu i BDI, Ahmeti: Vendim i padrejtë, të mos biem në asnjë grackë |
| ADRESA | `https://www.syri.net/politike/917074/kreu-i-bdi-ahmeti-vendim-i-padrejte-te-mos-biem-ne-asnje-gracke/` |
| BURIMI | syri.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 12:27:31 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 11:55:56 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `741c12637972cc3777881d9a3e17ff13a6564a40defbf129b22d7170290630cb` |
| TEKSTI | `a6a5e6cf0c6f0905025164bb45a105cf7564badb553e0b5b2d33cada296be7d7` |
| PAMJA | `e75ab5cd7a4b15462ba6499339c47dd76310761f7a8ce10f0f4e69bbf9f4ea1f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `9e44d3a5686bc68bc83d9efa9f8a9017b37df1345b995fee163609c8bae03d09` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `aa4643f280403755043cdd17fa8b750c8d4cc9789c755656633151c3e6ad021e` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/9e44d3a5686bc68bc83d9efa9f8a9017b37df1345b995fee163609c8bae03d09`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px


NDRIÇIM KULLA
Gjuha si brushë dhe ironia si armë e Edi Ramës


IRENA BEQIRAJ
Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

LAJMI I FUNDIT
Reagimi/ Kurti: Udhëheqësit e UÇK-së nuk u dënuan me vullnetin e popullit



# Kreu i BDI, Ahmeti: Vendim i padrejtë, të mos biem në asnjë grackë

13:55, 16/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

+ A - 

**Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim, Ali Ahmeti, ka reaguar pas shpalljes së aktgjykimit nga Dhomat e Specializuara në Hagë ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ku Hashim Thaçi e Jakup Krasniqi u dënuan me nga 25 vjet burg, Kadri Veseli me 18 vjet dhe Rexhep Selimi, me 13 vjet burg.**

Ahmeti e ka cilësuar vendimin si të padrejtë dhe thellësisht zhgënjyes, duke bërë thirrje për maturi dhe unitet në këto momente të rënda.

“Vendimi i sotëm ndaj Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit është një vendim që e konsideroj të padrejtë dhe thellësisht zhgënjyes. Në këto momente të rënda, bëj thirrje për maturi dhe unitet. Nuk duhet të biem në asnjë grackë që synon të krijojë tensione, përçarje apo të njollosë luftën çlirimtare të popullit në Kosovë”, shkroi Ahmeti.

Ai rikujtoi se Ushtria Çlirimtare e Kosovës lindi si përgjigje ndaj shtypjes dhe luftoi për lirinë e vendit. Ahmeti theksoi se pretendimet e dikurshme për trafikim organesh, që për vite rënduan mbi UÇK-në dhe drejtuesit e saj, nuk u shndërruan në akuza në këtë proces, ndërsa Gjykata i shpalli të pafajshëm të akuzuarit për krime kundër njerëzimit, duke potencuar se UÇK kishte si objektiv pavarësinë e Kosovës – një objektiv që u arrit.

“Historia e Kosovës nuk mund të rishkruhet dhe sakrifica e një populli të tërë nuk mund të vihet në bankën e të akuzuarve”, theksoi Ahmeti, duke shtuar se aktakuza i ngarkonte Thaçin, Krasniqin, Veselin dhe Selimin me përgjegjësi për një sërë krimesh të pretenduara gjatë viteve 1998-1999, por se beson që edhe këto akuza do të rrëzohen në procesin e mëtejshëm gjyqësor.

Ai nënvizoi se procesi nuk përfundon këtu dhe se mbrojtja do të vazhdojë betejën juridike në Gjykatën e Apelit, duke kundërshtuar gjetjet e shkallës së parë dhe

## më të lexuarat

Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin

Specialja: Të akuzuarit vepruan së bashku për një qëllim të përbashkët kriminal, Thaçi ishte anëtar kyç

‘Mafia emëron ministrat në qeverinë Rama’, Kepi: E kanë të lehtë të gjejnë personin e duhur për aferat e tyre

'Thaçi kishte dijeni për krimet, Veseli mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e tyre'

Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina i përket Klubit Labëria, po zhduket historia

PD: Shpopullimi i Shqipërisë, një krizë që po zbraz vendin dhe po rrezikon të ardhmen e tij

juridike në Gjykatën e Apelit, duke kundërshtuar gjetjet e shkallës së parë dhe duke kërkuar drejtësi deri në fund.

“Me besim në drejtësi, beteja vazhdon në apel”, tha Ahmeti./ RTK.

© SYRI.net

Lexo edhe:


Reagimi/ Kurti: Udhëheqësit e UÇK-së nuk u dënuan me vullnetin e popullit


Ftesa/ Berisha: Vizita ime në SHBA duhet të shërbejë si një apel bashkimi për të gjithë demokratët


Vendimi i Hagës/ Osmani: UÇK, pjesa më krenare e historisë moderne të popullit tonë: dje, sot e përjetësisht!

Urimi dhe mesazhi i Metës: PISA janë një tjetër dëshmi e gjendjes alarmante të shkollave! Për PL-në arsimi prioritet

'Selimi dha kontribut në zbatimin e qëllimit të përbashkët kriminal, mori pjesë në kryerjen e krimeve'

Ngërçi me pagat/ Gjykata e Kukësit mbyll dyert për qytetarët 3 ditë

TË NGJASHME

Vendimi i Hagës/ Thirrje për protesta më të fuqishme, griset flamuri i BE

Berisha: Vendimi për ish-drejtuesit e UÇK-së i padrejtë! Asgjë s' mund të errësojë luftën çlirimtare të popullit të Kosovës

'Dënime absurde, qartazi politike', Meta: Lufta e UÇK meriton piedestalin e krenarisë patriotike

Tensione pranë ish-ndërtesës së EULEX-it në Prishtinë, qytetarët mësyjnë selinë e rrethuar nga Policia

Dënimi i ish krerëve të UÇK-së/ BE-ja bën thirrje për përmbajtje: Gjykata ta kryejë punën pa ndërhyrje

Elshani: Situatë e qetë në veri, Policia e gatshme të reagojë në rast incidentesh

Audiopërgjimi i Ahmetajt/ Reagon shoqëria DEL-CNG SHPK



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.